



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.07.2024

Nr: 119

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË BASHKIMIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR  
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Sot më datë 23.07.2024, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 2068 Prot., datë 19.07.2024, me:

**Kërkues:** “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, me kryetar z.Vangjel Dule

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” (PBDNJ), si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

**V Ë R E J:**

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 244, datë 5.7.2024, ka caktuar datën 4 gusht 2024, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë.

Data: 23.07.2024 Nr: 119  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

“Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Vangjel Dule, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024.

Nga “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 09.07.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, me iniciale “PBDNJ” me kryetar z. Vangjel Dule, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut” me shkronja nistore “PBDNJ”, me adresë Selia e Kuvendit, Grupi Parlamentar “Aleanca për Ndryshim”, (AN), Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Vangjel Dule, me adresë “Kuvendi”, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Mihal Naço, me adresë Rruga “Zenel Gjoleka”, banesa nr. 4, kati i 2-të, Tiranë;
- d) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Thodhori Kamberi, me adresë Rruga “Pjetër Budi”, nr. 19, kati i 4-të, hyrja 16, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë;
- e) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, respekton afatin kohor të parashikuar në vendimin nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

## VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut”, me kryetar z. Vangjel Dule, me shkronjat nistore “PBDNJ”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orë nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**